

## të zhdukurit

Në mbarë botën sot ka miliona raste të raportuara mbi personat e zhdukur nga konfliktet e armatosura dhe abuzimet me të drejtat e njeriut. Problemi i personave të humbur dhe të zhdukur është intensifikuar gjatë dy dekadave të fundit. Ndryshimet klimatike dhe degradimi mjedisor kanë çuar në fatkeqësi natyrore dhe migrim masiv. Paqëndrueshmëria politike në shumë pjesë të botës ka rezultuar në abuzime endemike të të drejtave të njeriut dhe dështime nga shtetet për të mbështetur sundimin e ligjit. Teksa çështja e personave të zhdukur është vetëm një aspekt i një deficiti global në sigurinë njerëzore, është një çështje vendimtare. Dështimi i qeverive që të japin llogari për një numër të madh personash që shkojnë të humbur për arsye të pavullnetshme është një shfuqizim themelor i sundimit të ligjit. Prandaj, përgjegjësia dhe veprimi i shtetit është thelbësor si në nivel vendor ashtu edhe ndërkombëtar.

## mandati

ICMP është një organizatë ndërkombëtare e pavarur, e themeluar nëpërmjet një traktati, me seli në Hagë, me më shumë se 20 vjet përvojë në 40 vende. Është e vetmja organizatë ndërkombëtare e ngarkuar ekskluzivisht për të punuar mbi çështjen e personave të zhdukur. Ajo ndihmon qeveritë të ndërtojnë institucione të sundimit të ligjit të cilat me sukses dhe paanshmëri kërkojnë dhe identifikojnë personat e zhdukur dhe mbështesin përpjekjet për të zhvilluar legjislacionin që t'u mundësojë familjeve të të zhdukurve mbrojtjen e të drejtave të tyre. ICMP ka ndihmuar autoritetet në përdorimin e teknikave të avancuara mjeko-ligjore, duke përfshirë përdorimin e metodave moderne të ADN-së për të gjetur dhe identifikuar personat e zhdukur nga një sërë rrethanash në pjesë të ndryshme të botës. ICMP mban aftësinë e vetme jo fitimprurëse në botë për të kryer një identifikim njerëzor të udhëhequr nga ADN-ja. ICMP gjithashtu u përgjigjet kërkesave për dokumentacion dhe ekspertizë nga gjykatat ndërkombëtare dhe vendore për çështjet që kanë të bëjnë me krimet e luftës, krimet kundër njerëzimit, genocidi dhe krime të tjera sipas ligjit ndërkombëtar.

## programe ndërsektoriale

ICMP operon pesë programe ndërsektoriale. **Programi i Zhvillimit të Institucioneve dhe Shoqërisë Civile** kontribuon në drejtësinë tranzicionale, siguron mbështetje legjislative dhe mbështet zhvillimin e rrjeteve të organizatave të shoqërisë civile që avokojnë për të vërtetën, drejtësinë dhe të drejtat e anëtarëve të familjes së personave të zhdukur. ICSD menaxhon Forumin Global për Personat e Zhdukur, i cili bashkon ekspertë, zyrtarë qeveritarë dhe palë të tjera të interesit nga e gjithë bota për të zhvilluar mirëkuptimin dhe promovimin e veprimeve për çështjen e personave të zhdukur. **Programi i Shkencës dhe Teknologjisë** ofron zgjidhje teknike të avancuara përmes asistencës së drejtpërdrejtë teknike duke përfshirë trajnimin dhe ngritjen e kapaciteteve, si dhe testimin e identifikimit të ADN me performancë të lartë dhe ekspertizë në arkeologji dhe antropologji. **Programi i Sistemeve të të Dhënave** mban Sistemin e Menaxhimit të të Dhënave të Identifikimit të ICMP (iDMS), i cili mbledh, ruan, mbron dhe ndan të dhënat mbi personat e zhdukur në mënyrë të sigurt. iDMS mund të arrihet nga kudo në botë nga ata që dëshirojnë të japin informacion mbi personat e zhdukur, duke përdorur Qendrën e Hetimeve Online të ICMP. **Programi i Ndihmës së Sektorit të Drejtësisë** mbështet nismat legjislative ndërkombëtare dhe vendore për të llogaritur të zhdukurit, bazuar në proceset demokratike dhe sundimin e ligjit. **Qendra e Programit për Përsosmëri dhe Trajnim** mundëson transferimin e aftësive, strategjive dhe praktikave më të mira të zhvilluara nga ICMP. Ai zhvillon kurse trajnimi në testimin e identifikimit të ADN-së, informatikë të avancuar të bazës së të dhënave, gjërmim të varreve masive dhe klandestine, procedura zinxhir-kujdestarie dhe menaxhim të skenës së krimet.

## historia

ICMP u krijua në Samitin e G-7 të vitit 1996 për të trajtuar çështjen e personave të zhdukur si pasojë e konflikteve në Ballkanin Perëndimor. Ajo udhëhoqi një përpjekje që bëri të mundur identifikimin e më shumë se 70 përqind të këtyre viktimave, duke përfshirë 7,000 nga 8,000 të zhdukur në Srebrenicë në korrik të vitit 1995. Duke filluar nga viti 2004, ajo filloi të punojë në nivel global. Në vitin 2014, Holanda, Mbretëria e Bashkuar, Belgjika, Suedia dhe Luksemburgu nënshkruan një marrëveshje ndërkombëtare që themeloi ICMP si një organizatë ndërqeveritare me seli në Hagë për t'iu përgjigjur sfidës globale të personave të pagjetur. Traktati është nënshkruar prej Kilit, Qipros, El Salvadorit dhe Serbisë dhe është i hapur për aderim nga të gjitha shtetet.

## komisionerët

Kryesuesi aktual i ICMP-së është ish ambasadori amerikan Thomas Miller. Komisionerët e tij janë Lartëmadhëria e sajë Mbretëresha Noor / Ambasadori Knut Vollebæk, ish-Ministër i Jashtëm i Norvegjisë / Ambasadori Rolf Ekéus, ish-Komisioner i Lartë i OSBE-së për Pakicat Kombëtare / Alistair Burt, dhe Ministri i Shtetit për Lindjen e Mesme dhe Ministër i Shtetit në Departamentin për Zhvillim Ndërkombëtar i Qeverisë së MB / Gjykatësit Sanji M. Monageng, Gjykatë Penale Ndërkombëtare/Bet Koenders, ish-Ministër i Jashtëm i Hollandës/Maria Eugenia Briyuela de Avila, ish-Ministre e Jashtme e El Salvadorit.

## financimi

ICMP financohet tërësisht vullnetarisht dhe kryesisht nga qeveritë. Financimi është siguruar ndër të tjera nga Kanadaja, Kili, Republika Çeke, Danimarka, Finlanda, Franca, Gjermania, Greqia, Selia e Shenjtë, Islanda, Irlanda, Italia, Luksemburgu, Holanda, Qyteti i Hagës, Norvegjia, Polonia, Spanja, Suedia, Zvicra, Tailanda, Turqia, Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara, si dhe Kombet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian. Mbështetje të veçantë për projektin është siguruar, ndër të tjera, nga Fondacioni Charles Stewart Mott dhe Fondacioni Robert Bosch, Interpol, Universiteti i Kalifornisë, Berkeley, EULEX, Instituti Ligjor i Holandës (NFI) dhe Policia e Afrikës së Jugut; ndërsa donacionet në natyrë janë pranuar nga Microsoft, Instituti i Kërkimeve të Sistemeve Mjedisore (ESRI), Oracle Corporation dhe Qiagen.



Zyra Qëndrore e ICMP  
Koninginnegracht 12  
2514 AA Hagë  
Hollandë

Adresa e E-mail:  
icmp@icmp.int  
Rrjeti: www.icmp.int